



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

VENDIM

Nr. 394, datë 22.09.2021

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES PËR NGRITJEN NË
DETYRË NË GJYKATËN E POSAÇME TË APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE
KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR POZICIONET E LIRA TË SHPALLURA
ME VENDIMET NR. 119 DHE NR. 120, DATË 01.04.2021,
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 4, të nenit 135, pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 8 dhe 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 24, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, mbas shortit për zgjedhjen e relatorëve,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 119 dhe nr. 120, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e z. Ilir Toska, si relator të procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR